



Pranuar / Dorezuar Punëpunë/Prodato Received/Delivered	04.05.2022	2	viti god year
Organ / Njësia Organ / Jednica Org / Unit	Nr. Prot. Br. Prot. Prot. No	Shtesa Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKIMSHICK	2582/2022		113



Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.276/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj-Demi-kryetare, Arben Mehmeti dhe Jeton Koca-anëtarë, me Ilire Mehmeti- Shaqiri Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën A.nr.276/2022 të datës 23.03.2022 të parashtruar nga ankuesja kundër organit të punësimit Komuna e Mitrovicës, në çështjen juridike "kompensim material", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nënparagrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 04.05.2022, mori këtë:

V E N D I M

Hedhet poshtë si e palejuar ankesa me numër A.nr.276/2022 e datës 23.03.2022 e parashtruar nga ankuesja

A r s y e t i m

Ankuesja e punësuar në Komunën e Mitrovicës, më datë 23.03.2022 ka parashtruar ankesë me numër protokollit 1550/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës me pretendimin ankimor për mos harmonizimit të koeficientit të pagës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (tutje referuar Këshilli) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 31.03.2022 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesën e ankueses në Komunën e Mitrovicës, ndërsa kjo e fundit më datë 14.04.2022 ka përcjell shkresat lidhur me çështjen në procedurë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka administruar këto prova: Ankesën me numër të protokollit 1150/2022 të datës 23.03.2022; Ndryshimin dhe Plotësimin i Akt Emërimit me numër të protokollit 01-101/3-0047494 të datës 15.06.2021; Përshkrimin e detyrave të punës për

pozitën Zyrtar i Larte për Çështje Juridike; Letër Rekomandimin e datës 20.02.2017; Certifikatën e lëshuar nga USAID dhe AUK në Tetor 2017; Provën shtesë të datës 05.04.2022 me numër të protokollit 1857/2022; Kërkesën me numër 01-120/04-0020275/22 të datës 03.03.2022 për harmonizimin e koeficientit; Ankesën me numër të protokollit 01-112/02-0039897/21 të datës 28.05.2021; Akt Emërimit e datës 11.10.2012; Kërkesën për përgjigje ne ankesë me numër të protokollit 1767/2022 të datës 31.03.2022; Përgjigjen në ankesë me numër të protokollit 2106/2022 të datës 14.04.2022; Listën e pagave për periudhën kohore 01.02.2022 deri me datën 28.02.2022; Listën e pagave për periudhën kohore 01.03.2022 deri me datën 31.03.2022; Vendimin me numër të protokollit 2398/2021 të datës 14.05.2021 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës;

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas shqyrtimit dhe analizimit të provave të parashtruara nga palat në procedurë, konstatoi së ankesa e ankueses *është palejuar,*
SEPSE:

Bazuar në shkresat e lëndës Kolegji ka konstatuar se ankuesja në bazë të Akt emërimit me numër të protokollit 01-101/03-0047494/ të datës 15.06.2021 dhe Akt emërimit të datës 11.10.2012 është e punësuar në Drejtorinë e Shërbimeve Publike dhe Infrastrukturës në Komunën e Mitrovicës. E njëjta me datë 03.03.2022 i është drejtuar me kërkesë organit të punësimit për harmonizim të koeficientit të pagës nga 7 në 8, ndërsa më datë 23.03.2022 parashtron ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil me pretendim të njëjtë gjegjësisht harmonizim të koeficientit të pagës nga shtatë (7) në tetë (8).

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave duke u bazuar në nenin 125 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, me të cilin është përcaktuar se: *Përpos nëse është paraparë ndryshe me ligj, ankesa mund të parashtrohet kundër një akti administrativ apo ndaj mosveprimit të organit publik brenda afatit të përcaktuar për përfundimin e procedurës administrative (në vijim: "heshtja administrative")",* ndërlikur me këtë neni 127 përcakton se : 1. Ankesa duhet të parashtrohet brenda tridhjetë (30) ditëve nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ... 4. Ankesa kundrejt heshtjes administrative mund të parashtrohet jo më herët se shtatë (7) ditë dhe jo më vonë se dy (2) muaj pas skadimit të afatit për njoftimin e aktit administrativ, rrjedhimisht Kolegji në kuptim të këtyre dispozitave ligjore dhe duke u bazuar në shkresat e lëndës, ka konstatuar se ankuesja ka parashtruar paraprakisht kërkesë për harmonizim të koeficientit të pagës të organi i punësimi dhe ende pa kaluar afati ligjore për vendosje lidhur me kërkesën e saj siç përcaktohet me nenin 98 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, e njëjta ushtron ankesë me pretendim të njëjtë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës. Andaj mbi këtë bazë Kolegji konstaton se ankesa e ankueses është e palejueshme në kuptim të nenit 129 paragrafi 1 nënparagrafi 1.4 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Po ashtu Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e ankesave sjell në vëmendje edhe dispozitat e nenit 24 paragrafi 3 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë me të cilin është përcaktuar se 3. *Nëpunësi civil ka të drejtë të paraqesë ankesë drejtpërdrejt në KPMSHC për çdo veprim apo mosveprim, që i cenon të drejtat apo interesat e ligjshme, të drejta këto, që burojnë nga marrëdhënia e Shërbimit Civil, si dhe*



dispozitat e nenit 124 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ku përcaktohet se: *1.Pala ka të drejtë të ushtrojë mjetet juridike administrative ndaj çdo veprimi apo mosveprimi administrativ, nëse pretendon se të drejtat apo interesat e saj juridike cenohen nga ky veprim apo mosveprim, respektivisht lidhur me objektin e ankesës në shqyrtim, nuk kemi veprim apo mosveprim të organit të punësimit në raport me të drejtën e pretenduar në ankesë, kështu që mbi këtë bazë ligjore rrjedhë së ankesa mund të parashtrohet vetëm kundër një veprimi/akti administrativ apo mosveprimi/heshtjes administrative e me të cilin pretendohet se janë shkelura apo cenuar të drejtat dhe interesat juridike nga marrëdhënia e punës në shërbim civil.*

Bazuar në këto rrethana, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: *Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.*

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.276/2022

Ilire Mehmeti-Shaqiri

[Signature]
Procesmbajtëse



Vendimi i dorëzohet:

- Ankueses
- Kryetarit të Komunës së Mitrovicës;
- Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore të Komunës së Mitrovicës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

